



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:222154

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05906264

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ–Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B. nga Ferizaji ,me numër personal të cilin në bazë të autorizimit i përfaqëson av.Zejnije Bega ,nga Ferizaji, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës në Prishtinë-Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B. nga Ferizaji ,me numër personal..... dhe detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë që paditësit A.B. në emër të tri pagave përcjellse pas pensionit tia paguaj shumë prej 1672.92 euro ,me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis 19.10.2023 e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit .

II. Detyrohen e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë që paditësit A.B. ,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tua paguaj shumat siq vijon :per hartimin e padis 104 euro,për taksen për padi 30 euro,për një seancë gjyqësore 135.20 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi A.B. , ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinl ,me bazë juridike pagesa në emër të pagave përcjellëse.

Nga thënjet e paditësit rezulton se i njejtj padin e bazon në faktin se ka qenë në mardhënje të punës në policinën e Kosovës dhe për shkak të arritjes së moshës 65 vjeqare është pennsionuar,por e paditura nuk ia ka paguar tri paga përcjellse pas pensionimit edhe pse një e drejtë e tillë i takon paditësit në bazë të udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi

Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me date 29.09.2021 konkretisht nën 89 paragrafi 3 ,me të cilin është paraparë se personeli i policisë i cili pensionohet gëzon të drejtën në tri paga përcjellse në lartësi të pagës së fundit.

Përfaqësuesja e autorizuar i paditësit av.Zejnije Bega ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia me përmbajtje si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pika I dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën II.

E paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë-Drejtoria Rajonale në Ferizaj, në përgjegjeje në padi përmes avokaturës shtetërore e ka kundërshtuar padin dhe kërkesëpadin e paditësve duke u bazuar në theksimet si në vijim: pensionimi i paditësit ka ndollur me datë 08.02.2023 , pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat në sektorin Publik me datë 05.02.2023 dhe Ligjit për Pagat në sektorin Publik me nenin 45 paragrafi 1 ,pika 1.11 ka përcaktuar në mënyrë takstative se me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet neni 47 paragrafi 4 i Ligjit për Policinë ,ndërsa me paragrafin 2 të nenit 45 të Ligjit për Pagat është paraparë se shfuqizohet qdo dispozitë e ligjit apo aktit tjetër që rregullon çështjen e pagës ,kompensimeve ,shtesave ,shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave ,e që nuk është autorizuar për tu nxjerr nga dispozitat e këtij ligji.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues ekzistimi i faktit se paditësi ka qenë në marrëdhënjet punë në Policinë e Kosovës dhe është pensionuar ,por këto fakte vërtetohen edhe nga provat: vendimi me numëri datës 23.01.2023,i lëshuar nga e paditura ,vërtetimi nr....., i lëshuar nga e paditura, kontrata e marrëdhënjes së punës ,e datës 15.04.2010 ,me numërvërtetimi i datës 30.08.2022 ,me numër i lëshuar nga e paditura, vendimi ,i datës 27.03.2023 ,nr.....,i lëshuar nga e paditura.

Me leximin e vërtetimi i datës 30.08.2022 ,me numër i lëshuar nga e paditura gjykata ka vërtetuar se paditësi para pensionimit kishte pagë mujore 557.64 euro në muaj, e që 557.64 x3 bëjnë 1672.92 euro.

Gjykata pasi vlerësoj provat e administruara ka aprovuar si të bazuar kërkesë kërkesëpadin e paditësit sepse nga provat e administruara u vërtetuar se i njëjti ishte në marrëdhënie pune në policinë e Kosovës dhe ishte pensionuar me datën 08.02.2023, por e paditura nuk ia ka paguar tri paga përcjellse pas pensionimit edhe pse një e drejtë e tillë i takon paditësit në bazë të udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi me date 29.09.2021 konkretisht nën 89 paragrafi 3 ,me të cilin është paraparë se personeli i policisë i cili pensionohet gëzon të drejtën në tri paga përcjellse në lartësi të pagës së fundit.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e të paditurës në arsyetimin e këtij aktgjykimi në lidhje me shfuqizimin e qdo dispozitë e ligjit apo aktit tjetër që rregullon çështjen e pagës ,kompensimeve ,shtesave ,shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave ,e që nuk

është autorizuar për tu nxjerr nga dispozitat e këtij ligji i pagave, por kjo gjykatë këto theksime i quan të pa bazuara, sepse paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit për Pagat me të cilin është paraparë se shfuqizohet qdo dispozitë e ligjit apo aktit tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar për tu nxjerr nga dispozitat e këtij ligji është anuluar nga Gjykata e Kushtetuesë e Kosovës me aktgjykimin KO79/23, i datës 23.01.2024, me paragrafin VII të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe se me anulimin e ligjit në fjalë i njëjti në pjesën e anuluar nuk krijon efekte juridike.

Sa i përket faktit se çka konsiderohet pagë është dhënë kuptimi nga Ligji Punës i Kosovës në nenin 3 paragrafi 1 pika 1.13 me të cilën dispozitë është paraparë se pagë konsiderohet shpërblimi ose fitimi i çfarëdo niveli të llogaritur e shprehur në para për të punësuarin. Kjo nënkupton se qdo pages që i bëhet të punësuarit në lidhje me punën konsiderohet pagë.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së.

Vendimi për pagesën e shpenzimeve procedural është bazuar në nenin 451.2 të LPK-së, i cili vendim është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Gjyqtari,
Burim Emërllahu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.